
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Riparim i mjeteve teknologjike ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50000000-5 shërbime mirëmbajtje dhe riparimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 200 000(katermilion e dyqind mije) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 9, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e përlogaritur duhet të jete jo me e vogël se 1 680 000 leke pa tvsh (40%)te vleres se parashikuar te kontrates. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore (2022, 2023, 2024), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Cdo tatim pages pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuara ne Udhëzimin e Ministrisë të Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 840 000 lek pa tvsh (20%) të vlerës së të vlerës së fondit të limit të kontratës

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Plotesi prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda vlerës limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme

me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.1 Operatori ekonomik pjesmarres, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponoj personel kryesor si më poshtë :

a) Inxhinier mekanik – 1(nje)

Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese :

a) kontraten individuale te punes

b) nje dokument (deshmi kualifikimi profesional/certifikate/diplome)qe te vertetoje kualifikimin profesional si me siper

c) te figuroje ne liste pagese te pakten muajin e fundit te zhvillimit te procedures.

b) Operatori ekonomik pjesmarres, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate duhet të disponoj personel kryesor si më poshtë :

a) Mekanik – 1(nje)

b) Shofer- 2(dy)

c) Puntore/ndihmes- 3(tre)

Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese :

a) kontraten individuale te punes

b) nje dokument (deshmi kualifikimi profesional/certifikate/diplome)qe te vertetoje kualifikimin profesional si me siper

c) te figuroje ne liste pagese te pakten muajin e fundit te zhvillimit te procedures

Argumentimi: për të kryer shërbime riparimi në mjetet teknologjike dhe instalime hidraulike është i domosdoshëm një **inxhinier mekanik** për diagnostikim dhe mbikëqyrje teknike. Harton zgjidhje teknike, kontrollon cilësinë e punimeve dhe sigurinë. Ndërhyrjet hidraulike kërkojnë verifikim profesional nga inxhinier i licencuar. Kriteri mbështetet në ligjin nr 162/2020 për prokurimin publik ,neni 45 dhe 46: kërkesa për kapacitete profesionale. I ndryshuar **Nje mekanik** realizon ndërhyrjet praktike në sisteme hidraulike, pompa, motorra. Zbaton punimet sipas udhëzimeve të inxhinierit. Kriteri mbështetet në ligjin nr 162/2020 për prokurimin publik ,neni 45 dhe 46: kërkesa për kapacitete profesionale, - VKM 285/2020 për provat e kualifikimit. **Dy shofere** I nevojshëm për lëvizjen e 2 mjeteve teknologjike dhe pajisjeve. Siguron transport dhe manovrim nga Ak në oficinën e operatorit ekonomik dhe anasjelltas. - Ligji 162/2020: kapacitete teknike të nevojshme. VKM 285/2020. **Tre puntore ndihmes** - Ndihmojnë në punimet fizike, çmontim/montim, përgatitje të vendit të punës.- Procesi hidraulik kërkon staf mbështetës për realizim efektiv. - Ligji 162/2020, Për prokurimin publik “ I ndryshuar neni 46. - VKM 285/2020.”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për kokat e sondes ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

2.3.3 Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 45001 ose ekuivalent dhe ISO 9001 ose ekuivalent për sistemin e menaxhimit të cilësisë, dhe të ofrojë certifikata të vlefshme për përputhshmërinë e produktit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr 162/2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, ku parashikon që autoritetet kontraktore mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë kërkesat në lidhje me: “cilësinë, kapacitetin teknik, dhe profesional si dhe me standartet e menaxhimit të cilësisë dhe të sigurisë në punë”

Kërkesa për certifikime bazohet në standarde të njohura ndërkombëtare si ISO, OHSAS, EN etj, por gjithmone duke pranuar ekuivalentet

VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcakton se AK mund të kërkojë që prodhuesit ose operatorët ekonomikë të posedojnë certifikatat ISO për menaxhimin e cilësisë etj në përputhje me natyrën e furnizimit.

Certifikata ISO 45001:2018 (ose ekuivalent) është standart për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila siguron që prodhuesi ka implementuar masa parandalimi të aksidenteve, kontrollin e rrisqeve, dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë gjatë procesit të prodhimit të pajisjeve. Si dhe ky standart është garanci për produkte të prodhuara sipas praktikave ndërkombëtare.

Certifikata ISO 9001:2015 ose ekuivalente është standart ndërkombëtar për menaxhimin e cilësisë, i cili siguron se prodhuesi zbaton procese të kontrolluara për projektimin, prodhimin, testimin dhe shpërndarjen e pajisjeve

Te dyja certifikatat e kërkuara risin sigurinë e furnizimit me produkte të cilësisë së garantuar

Minimizojnë riskun teknik, siguron kontroll cilësie dhe është në përputhje me natyrën e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë prane Autoritetit kontraktor ne rast se shpallet fitues, kokat e sondes, per verifikim nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa per paraqitjen fizike te kokave te sondes pas shpalljes fitues te operatorit ekonomik bazohet ne faktin se koka e sondes eshte element i rendesishem ne funksionimin e mjeteve teknologjike dhe pajisjeve hidraulike qe kryejne shpim , pastrim, skanim ose nderhyrje teknike.

Ajo percakton cilesine , presionin e punes, materialin, rezistencen dimensionet dhe pershtatshmerine me pajisjet ekzistuese.Verifikimi fizik eshte i domosdoshem per te shmangur dorezimin e pajisjeve te pasakta dhe qe nuk perputhen me specifikimet teknike , zvendesimin e produkteve me artikuj te dobet.pa kete kontroll paraprak autoriteti kontraktor nuk mund te garantoje qe operatori ekonomik do te perdore pajisjet e deklaruar ne oferte.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë transportin e mjeteve nga vendparkimi i AK drejt oficines dhe kthimin e tyre prane AK.

Argumentimi: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Kjo kerkese eshte e aresyeshme dhe propocionale me objektin e kontrates, pasi garanton qe mjetet te dorezohen ne menyre te sigurt ne kohe dhe pa kosto shtese per AK duke ruajtur integritetin dhe cilesine e tyre deri ne momentin e dorezimit.

2.3.6Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të testojë prane autoritetit kontraktor mjetet mbas nderrimit te pjeseve te demtuara.

Argumentimi: Me ane te testimit te mjeteve teknologjike mbas nderimit te pjeseve , verifikohet qe riparimi eshte kryer me cilesi dhe mjeti funksionon pa defekte, , siguron qe pjesa e re eshte montuar sic duhet dhe pajisja eshte e sigurt per perdorim, parandalon demtime te tjera te mundshme , aksidente . I mundeson AK kontroll te drejtperdrejte mbi cilesine e punimeve.

2.3.7Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër se duhet te ktheje prane AK te gjitha pjeset e nderruara nga automjetet teknologjike.

Argumentimi:Kthimi i pjeseve te demtuara eshte i rendesishem pasi : pjesa e demtuar sherben si prove per defektin e konstatuar . AK mund te verifikojë realisht se cilat pjese jane zvendesuar.Parandalon keqperdorimin , riciklimin ilegal ose shitjen e pjeseve te hequra.Siguron transparence totale mbi procesin e riparimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancise se mallit per 12 muaj nga momenti i I dorezimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër se mallrat objekt prokurimit janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara si dhe marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi, mirëmbajtja dhe shërbimi pa pagesë.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedat teknike, CE, katalloget e pajisjeve te kerkuara ne specifikimet teknike, te perkthyer dhe te noterizuara.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë duhet te dorezojne dokumentacion teknik per secilin artikull te ofertuar ne menyre qe komisioni te vleresoje ne pëputhje me specifikimet teknike. Perktimi dhe noterizimi jane kerkesa administrative standarte per dokumentat ne gjuhe te huaj. Kjo kerkese eshte thelbësore per verifikimin e pëputhjes se ofertes me specifikimet teknike te kerkuara

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me paisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. Zorrë gome për pastrim kanalizimesh, 250 bar

Zorrë gome për pastrim kanalizimesh, e lehtë, shumë fleksibël dhe jashtëzakonisht rezistente ndaj konsumimit. Pesha e ulët dhe rrezja e vogël e përkuljes mundësojnë përdorim shumë të lehtë gjatë punës së përditshme. Rezistente ndaj vajit dhe kushteve atmosferike. E presuar me armatura – në njërën anë AGR (AG) dhe në anën tjetër DKR (IG).

Diametri i brendshëm (mm) -25

Trashësia e murit (mm)-7

Diametri i jashtëm (mm)-39

Presioni i punës (bar)-250

Presioni i testimit (bar)-625

Rrezja e përkuljes (mm)-110

Pesha (g/m)-860

Gjatësia (m)-200

Njësia- ml

2. Sonda te ndryshme

1-Sonde terheqese – Cope 2

Këndi i presionit 7° siguron, së bashku me sistemin 3D të drejtimit të ujit, performancë maksimale në terheqje dhe transportimin e ndotjes.

Diametri i lidhjes(mm/inch) -32/1’’

Sasia e ujit(l/min)- min 120

Diametri i pastrimit (mm)-150-400

Diametri dhe gjatesia(mm)- 80-150

Pesha (kg)- 2.5

Presioni godites (M/ASK)- 10 x M 8 ASK

Presioni qendror(M/ASK)- 1 x M 8 ASK

2-Sonde piramidale – Cope 2

Per te perballuar cdo bllokim me sistemin 3D të drejtimit të ujit, performancë maksimale në terheqjen dhe shtytjen e ndotjes.

Diametri i lidhjes(mm/inch) -32/1’’

Sasia e ujit(l/min)- min 200

Diametri i pastrimit (mm)- 200-500

Diametri dhe gjatesia(mm)- 75 x 160

Pesha (kg)- 2.3

Presioni godites (G/sw14)- 6 x G ¼" SW14

Presioni qendror(M/ASK/M/ISK)- 4 x M 8 ASK + 1 x M 10 ISK

3-Sonde Centrifugale-Cope 1

Sonde me mekanizem rrotullues për pastrim radial të tubave dhe kanalizimeve, që largon yndyrën, rrënjët dhe papastërtitë."

Diametri i lidhjes(mm/inch) -32/1''

Sasia e ujit(l/min)- min 150

Diametri i pastrimit (mm)- 150-400

Diametri dhe gjatësia(mm)- 80-170

Pesha (kg)- 4.7

Presioni qendror(M/ISK)- 6 x M 12 ISK

3. Zorre vakumi

Shumë fleksibël për automjetet e pastrimit të kanalizimeve, për thithjen e ujërave të përdorura, mbetjeve dhe përzierjeve nga kanalet. Shumë fleksibël edhe në temperatura të ulëta dhe ofron funksionim optimal brenda kasetës së automjetit. Përçues elektrik dhe shumë rezistent ndaj konsumimit.

Diametri i brendshëm(mm)- 15

Trashësia e murit(mm)-12

Diametri i jashtëm(mm)-174

Presioni i punës(bar)-2

Vakuumi(mws)- 9

Temperatura e punës- -30°C bis +85°C

Shtresa e brendshme -NR/BR, e zezë, e lëmuar, jo përçuese elektrikisht

Shtresa e jashtme- NR/BR, e zezë, me teksturë pëlhure

Përforcimet- Spiralë çeliku, fije bakri, shtresë tekstile

Rezistenca elektrike- <10 hoch 6 Ω

Faktori i sigurisë - 3.1

Rrezja e përkuljes(mm)-912

Pesha(g/mtr)-10500

Gjatësia(ml)-30

4. Rakorde per bashkimin e tubove Sistemi Perrot

Sistemi Perrot rakordi femer, material çelik, i galvanizuar

NW(mm)-159

Diametri i brendshëm(mm)- 152

Materialiteti- Celik i Galvanizuar

Sistemi Perrot rakordi mashkull, material çelik, i galvanizuar

NW(mm)-159

Diametri i brendshëm(mm)- 152

Materialiteti- Celik i Galvanizuar

5. Vaj hidraulik per pompen e presionit

Perdorimi:

Ingranazhe

Lloji i aplikimit:

transmetim mekanik / diferencial / bosht i mesëm

Klasa e viskozitetit:

SAE 80W-90

6. Vaj hidraulik per pompen e vakumit

Perdorimi:

Ingranazhe

Lloji i aplikimit:

transmetim mekanik / diferencial / bosht i mesëm

Klasa e viskozitetit:

SAE 30

7. Sherbimet periodike MAN TGS 26,320

Sipas te dhenave te lejes se qarkullimit

8. Sherbimet periodike MAN TGS 18,250

9. Saracineska pneumatike 4''

Saracineske me aktivizim pneumatike, me veprim të dyfishtë

Perberja – gize lamelare

Unaza izoluese -NBR

Shtresat - veshje me pluhur epoksi

Boshti - çelik inox 1.4304

Cilindri pneumatik -alumini

Valvula - Çelik inox 1.4301

Dimensioni – DN100

Gjatesia konstruktive(mm)-52

Presioni(bar)- 8

Pesha(kg)-13

10. Saracineska me leva mekanike 4''

Filetimi femër nga të dyja anët, me leve per hapje- mbyllje mekanike, mbyllja me ane te sferes se kromuar.

Gama e temperaturës: –20°C deri +150°C

Trupi: bronz i veshur me nikel

Sfera: bronz i veshur me krom

Unaza izoluese: PTFE

Dimensioni (inch)-4

Dimensioni ne (mm)-100

Presioni(bar)-14

11. Doreza: çelik i veshur, ngjyrë e kuqeSaracineska 6'' me leve

Valvul portë me teh e projektuar për llum (slurry), pa vida fiksimi. I pajisur me një vrimë për fiksimin ose bllokimin e levës së funksionimit.

Materialiteti – celik i galvanizuar

Dimensioni(mm/inch)-150/6’’

12. Nderrim valvulat e presionit

Valvul presioni me dy sfera, me porta anësore lidhjeje për valvul sigurie 1½’’ dhe me lidhje të sipërme 3/8’’ për manometër.

Dimensioni(inch)-1

